



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 52, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, pas debatit të zhvilluar në seancën plenare të mbajtur më 30 maj 2018, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate dhe të harmonizuar edhe me grupet tjera parlamentare, miratoi këtë:

REZOLUTË

Për heqjen e tërësishme të kontrollit për hyrje/daljet e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në pikat kufitare: Vermicë, Qafë Prush, dhe Qafë Morinë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të nisë procedurat e domosdoshme kushtetuese dhe ligjore për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare për hapjen e kufijve për qarkullimin e lirë të njerëzve, të cilët janë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës. Të gjitha procedurat e nevojshme në lidhje me këtë çështje të nisin menjëherë me miratimin e kësaj rezolute.
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet marrëveshjen bilaterale, e cila e heq detyrimin për qytetarët e të dy shteteve për të udhëtuar me letërnjoftim dhe pasaporta, duke lejuar që shtetasit e të dy shteteve respektive të udhëtojnë drejtpërdrejt dhe pa u penguar nëpërmjet pikave të kontrollit kufitar, duke përfshirë mos kontrollin e automjeteve me shpejtësi të reduktuar.
3. Realizimi i kësaj rezolute do të bëhet duke marrë në konsideratë praktikat më të mira evropiane dhe direktivat e Bashkimit Evropian për këtë çështje.

Nr. 06-R-005

Prishtinë, më 30.05.2018

Kryetari i Kuvendit,

Kadri VESELI

Rezoluta u dërgohet:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Grupeve parlamentare, dhe
- Arkivit të Kuvendit.